



#### Çfarë përfiton nëse investon në Shqipëri ...

Shqipëria synon të shndërrohet në një nga vendet me potencialin më të lartë për të bërë biznes. Me një pozicion gjeografik të favorshëm, me burime të shumta natyrore, me një krah të lirë pune, me mundësi të mëdha në sektorin e inovacionit dhe teknologjisë qëllimi kryesor është të jetë ndër vendet më të mira në rajon për të investuar. Falë edhe legjislacionit fiskal favorizues, forcës të re dhe shumë konkurruese të punës, aksesit në tregjet rajonale dhe Europiane, përfshirjes në marrëveshje të shumta tregtare, dhe mundësive të shumta në të gjithë fushat si turizmi, bujqësia, energjia, industria e lehtë përpunuese.

Por cilat janë lehtësitë që përfiton një investitor i huaj apo shqiptar nga Shqipëria?

#### Tatim fitimi

- Zero takse për biznesin e vogël deri 5 milion Lek
- 5% për biznesin e vogël dhe të mesëm nga 5-14 milion Lek
- 5% për industrinë ICT
- 5% në Agroturizëm
- 5% për Bashkimet Bujqësore
- Zero për hotelet me 5 vje për 10 vjet
- Tatimi dividendit 8%

#### Tatimi mbi vlerën e shtuar

- 6% TVSH për akomodimin në struktura akomoduese
- 6% për gjithë shërbimet e ofruara në hotelet me 5-vje
- Përrjashtim nga TVSH për inputet dhe makineritë dhe pajisjet bujqësore
- Zero TVSH për nënkontraktorët e përpunimit aktiv
- 6% TVSH për reklamat audiovizive
- 6% TVSH për librin

<https://www.adbc.al/cfare-perfiton-nese-investon-ne-shqiperi/>

## DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



#### Takimi i lidhjes së bizneseve greko-shqiptar të Greqisë së Veriut

Këtë fundjavë zhvilloi takimin e radhës dhe të parin për këtë vit lidhja e bizneseve greko-shqiptar të Greqisë së veriut, ku pjesëmarrëse ishte edhe Dhoma e Biznesit të Diasporës.

Takimi i lidhjes së biznesmenëve greko-shqiptar, i cili u zhvillua në Selanik kishte si qëllim promovimin e iniciativave të përbashkëta mes Shqipërisë dhe Greqisë, për të konsoliduar zhvillimin e marrëdhënieve të bizneseve dhe sipërmarrjeve shqiptare në Greqi dhe ato greke në Shqipëri.

Në fjalën e tij kryetar i shoqatës së profesionistëve greko-shqiptar z. Arian Gusho tha se ky është një takim i cili synon të kthehet në një traditë të përvitshme me qëllim ngritjen e një rrjeti sipërmarrësish profesionistë greko-shqiptarë në Greqinë e Veriut.

Lidhja e biznesmenëve greko-shqiptar është një strukturë e krijuar një vit më parë dhe aktualisht ka të anëtarësuar rreth 30 biznesmenë.

<https://www.adbc.al/takimi-i-lidhjes-se-bizneseve-greko-shqiptar-te-greqise-se-veriut/>



Konferenca e donatorëve “Bashkë për Shqipërinë”  
1.15 miliardë € për rindërtimin pas tërmetit

[> Link <](#)



Ekonomitë më të mëdha botërore po shkojnë drejt  
recesionit, koronavirusi ka ndikimin e tij

[>Link <](#)

## Java në lajme



Mbështetja e donatorëve, ekspertët: Ndikim pozitiv,  
rindërtimi sfidë e mundësi (Video)

[> Link <](#)



Kosovë/ Bashkimi i Doganës dhe ATK-së në funksion  
të ekonomisë

[> Link <](#)

## Tre vendime qeverie



### REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

Këshilli i Ministrave ka miratuar në mbledhjen e radhës vendimin për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në njësinë administrative Durrës, bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike si dhe realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;

Gjithashtu u miratua vendimi për hapjen e konsullatës së përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Strugë, Republika e Maqedonisë së Veriut.


Një tjetër vendimi i miratuar është vendimi për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bjellorusisë, për heqjen reciproke të kërkesave për vizë.

Në fushën e arsimit u vendos miratimi i vendimit për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës). Ky financim do të realizohet brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin përkatës për Fondin e Ekselencës, dhe nga donacione ose të ardhura të tjera, nga burime të ligjshme, për mbështetjen financiare të studentëve shqiptarë të shkëlqyer, i cili përdoret nga ministria përgjegjëse për arsimin për bursa për: studentët, të cilët ndjekin studimet e ciklit të dytë apo të tretë jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës dhe nëpunësit civilë.

Vendimet e plota mund ti lexoni këtu

<https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-19-shkurt-2020>

## Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	112.96	-0.17
Euro	EUR	122.21	0.00
Poundi Britanik	GBP	145.74	-0.38
Franga Zvicerane	CHF	115.16	-0.06
Jeni Japonez (100)	JPY	101.47	+0.24
Dollari Australian	AUD	74.44	-0.15
Dollari Kanadez	CAD	84.91	-0.40

### Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitoreve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.



Numrin e radhës të revistës Monitor mund ta lexoni këtu : [www.monitor.al](http://www.monitor.al)



Gazetën Çelësi mund ta lexoni këtu: <http://www.yellowpagesalbania.com>

